



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 43

Datë: 15. 08. 2024 ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Qemal Kurtis.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr.40 dhe 41/2024**
- 3. Aktivitete e Zyrës**
 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.07-2024 për Fushatën e Zgjedhjeve Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar
 2. Shqyrtimi i raportit përfundimtar “Auditimi i raporteve vjetore financiare të subjekteve politike – Pasqyrat financiare të vitit 2023”

4. Raport i Këshillave të KQZ

4.1. Këshilli për Personel

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr.13/2024 për shfrytëzimin dhe menaxhimin e automjeteve të KQZ.

2. Informatë lidhur me zbatimin e planit të rekrutimit për vitin 2024.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i listës së kandidateve potencial për anëtar të komisionit të pranimit për pozitën Drejtor i Sekretariatit të KQZ

4.2. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i video dhe radio spoteve për fushatën informuese për votuesit jashtë Kosovës
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rishikimit të Planit të Punës së KQZ 2024
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të realizimit të planit të punës së KQZ për periudhën janar - qershor 2024, për tre mujorin e dytë (T2)

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Në fillim të mbledhjes, kryetari Radoniqi e ka paraqitur një agjendë të gjatë të këtij takimi. Ndër të tjera, z. Radoniqi propozoi që “Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores nr. 7, duhet me qenë pikë e veçantë”, ndërsa pika “Këshilli për personel – dy çështje për miratim” të lihet të shqyrtohet në fund të takimit.

Alban Krasniqi, propozoi që “Rregullorja...”, të shqyrtohet pas pikës së KOZ-it.

Agjenda, u miratua me vota unanime.

2. Aktivite e Zyrës

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.07-2024 për Fushatën e Zgjedhjeve Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiarë:

Kreshnik Radoniqi: Grupi punues e ka shqyrtue, e ka përgatitë. E kemi pasur draftin, është përkthye dhe është dërgue edhe te komunitetit shumicë.

Sami Kurteshi, e vlerësoi si të mirë dhe të jashtëzakonshme përgatitjen e kësaj rregullore. Por, kam dy çështje, po i ngris këtu: Neni 4, paragrafi 3, dhe e dyta, neni 9, paragrafi 1. Ai, lexoi nenet dhe, dha analizën e vërejtjeve të tij. Kam marrë përgjigje, por po i ngris sërish.

Alban Krasniqi, tha se si për subjektet, KKZ, policia etj., është pa e udhës që në aspektin e planifikimit të lehtësohen procedurat, të ndahen këto deri në 200 pjesëmarrës. Ndërsa, për më shumë se 200 pjesëmarrës, kemi lënë kohë 48 që të gjithë faktorët të kenë mundësi ti bëjnë përgatitjet e duhura...

Besnik Buzhala, drejtor i Zyrës, shpjegoi se neni 7, “Materialet e fushatës zgjedhore”, se ku duhet të vendosen materialet e subjekteve politike. Ky nen, u analizua më shumë sepse, tërheqë konsekuenca eventuale të dënimit nëse materialet, nuk vendosen në ambiente adekuate...

Qemailj Kurtis, tha se është bërë një punë shumë e mirë, jashtëzakonisht e mirë e grupit. Diskutuan edhe: **Sami Hamiti dhe Ilir Gashi** dhe që të dy, ndanë mendimin që rregullorja është e mirë por te pjesa e informimit – “vendosja e ndalesave” duhet pasur vazhdimisht informim specifik në mënyrë që askush të mos vijë deri te dënimet... Gjithashtu, **Fazli Stollaj** e konsideroi si një prej rregulloreve më të rëndësishme.

Me ndryshimet e propozuara, me 8 vota për u miratua Rregullorja Zgjedhore Nr.07-2024 për Fushatën e Zgjedhjeve Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiarë.

2. Shqyrtimi i raportit përfundimtar “Auditimi i raporteve vjetore financiare të subjekteve politike – Pasqyrat financiare të vitit 2023” :

Besnik Buzhala, drejtues i Zyrës, tha se sa përket auditimeve financiare të partive politike 2023, auditimi ka filluar më 18 prill 2024. Nga gjithsej 54 subjekte të audituara, raporti tregon gjendjen e partive që prej atyre që janë në parlament, dhe të tjerat jashtë parlamentit. Buzhala, pasqyrooi shpenzimet e partive parlamentare, përqindjen e shpenzimeve. Ai tha se donacione në vitin 2023, 11 subjekte kanë pranuar donacione. Sa u përkt gjobave, Zyra ka gjobitur 14 subjekte, 7 prej tyre të përfaqësuara në kuvend. Për mosdeklarime dhe mungesë dokumentacioni, janë gjobiditur 5 subjekte dhe të tjerat, për arsye të ndryshme neglizhente dhe mos bashkëpunim të detyruar ligjor me zyrën...

Kreshnik Radoniqi: Ky është raport që do të shqyrtohet, nuk e votojmë...

Në këtë pikë, diskutuan: Alban Krasniqi, Ilir Gashi. Të dy, cilësuan në rregull respektimin e ligjit, cilësinë e punës së zyrës, por edhe nevojën që ligji të jetë i barazvlefshëm, të mos bëhen seleksionime etj. Diskutoi edhe Sami Kurteshi i cili nuk u pajtua me disa vlerësime të z. Gashi, Sami Hamiti i cili tha se zyra saktë e ka zbatuar ligjin nga të gjeturat. Ndërsa, ai tha se ligji për partitë politike, duhet të amandamentohet...Në vazhdim, foli edhe Fazli Stollaj, Kreshnik Radoniqi, Ibrahim Selmanaj i cili pyeti se subjektet pas shqiptimit të gjobave a ka pasur ankesa nga to...?

3.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i video dhe radio spoteve për fushatën informuese për votuesit jashtë Kosovës:

Alban Krasniqi, tha fillimisht se janë duke u bërë përgatitjet për simulim të procesit zgjedhor dhe se, detajet do të bëhen publike me kohë. Sa u përketë çështjeve me KOZ-in, janë në përfundim produktet që kanë të bëjnë me informimin publik, ato që lidhen me fushatën e mërgatës...

Në vazhdim, u prezantuan video – spotet para anëtarëve të KQZ-së në mënyrë që, të shihet përmbajtja dhe niveli i tyre para se ato të editohen...

Z. Krasniqi, elaboroi më tej konceptin e publikimit, vendet dhe rrjetet mediatike ku do të editohen, vendosjen e materialeve në vendet publike etj.

Në vazhdim, me 8 vota për u miratuan videspotet dhe materialet e tjera të infirmimit publik.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Rishikimit të Planit të Punës së KQZ 2024:

Në këtë pikë, referoi drejtori i Sekretariatit z. Burim Ahmetaj, i cili tha se sekretariati e ka përgatitur rishikimin e planit për tremujorin e dytë. Ai, tha se 21 aktivitete janë realizuar ,në realizim e sipër janë 10 aktivitetet, ndërsa 4 aktivitete nuk janë realizuar. Ahmetaj, kërkoi që organizimi i aktiviteteve me kryetarët e komunave të shtyhet, pastaj aktiviteti ‘lista e rreziqeve’, aktiviteti i sigurimit të procesit zgjedhor, dhe se mendojmë që gjatë këtij muji do të miratohen të gjitha rregulloret, pastaj plani i detajuar për informim ...

Ahmetaj tha se analiza e qendrave të votimit është në process, dhe kemi kërkuar që të përfundoj deri në tetor, rishikimi I të gjitha formave zgjedhore, dizajnimi i ueb faqes së KQZ, si dhe organizimi I punëtorisë mes komisionit të zgjedhjeve të Kosovës dhe Shqipërisë...

Rekomandojmë që të gjitha këto aktivitete, të shtyhen...

Diskutuan: Alban Krasniqi, Sami Kurteshi, Qemailj Kurtis.

Në fund, anëtarët e KQZ-së me 8 vota për miratuan raportin e rishikimit të Planit të Punës së KQZ 2024 me propozimet që u dhanë nga z. Burim Ahmetaj.

Në vazhdim, mbledhja vazhdoi me dyer të mbyllura. Në kontekst, nuk ka pasur incizim – stenogram të takimit...

4.Këshilli për Personel

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr.13/2024 për shfrytëzimin dhe menaxhimin e automjeteve të KQZ.
5. Informatë lidhur me zbatimin e planit të rekrutimit për vitin 2024.
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i listës së kandidateve potencial për anëtar të komisionit të pranimit për pozitën Drejtor i Sekretariatit të KQZ.

5.Të ndryshme!